



Prishtinë: 14.10.2020
Kodi i ZRRE-së: V_1302_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2084_08_20**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **06.10.2020**.

në seancën e mbajtur më datë 14.10.2020 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin M.S. nga Komuna e Prishtinës, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me nr. ZRRE/DMK_V_2084_08_20, i datës 31.08.2020.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 06.10.2020 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-s, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë, ndaj aplikuesit M.S. nga Komuna e Prishtinës lidhur me mosdhënien e lidhjes së re, për këto shkaqe: sipas Departamentit për Kujdes ndaj Konsumatorëve në KESCO, kërkesa e aplikuesit për lidhje të re është për objektin për të cilën është aprovuar kapaciteti energjetik, respektivisht në atë lokacion objekti është i energjizuar dhe ka kabllon e furnizimit. KESCO në ankesë ka theksuar se pas vendimit të DMK në ZRRE, ekipet e KEDS me datë 30.09.2020 kanë dalur te konsumatori për të inspektuar dhe kanë përpiluar procesverbalin nr.0729218 dhe kanë konstatuar se konsumatori nuk i ka përmbushur kushtet teknike për kyçe sipas Kodit të shpërndarjes, kapitullit IV, nenit 4, nenit 4.4.1.

KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2084_08_20, i datës 31.08.2020, për konsumatorin M.S.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 14.10.2020 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pikën e kundërshtimit të KESCO në të cilën aplikuesit për lidhje të re është për objektin për të cilën është aprovuar kapaciteti energjetik, Bordi i ZRRE-së thekson se bazuar në të gjitha shkresat e lëndës është e vërtetë se në atë objekt ekziston një shifër DPR – 90029614, por që sipas fotove të



siguraura nga aplikuesi për kyçje objekti posedon dy hyrje të ndara nga njëra tjetra, dhe objekti (shtëpia) është dy (2) kate. Pra duhet theksuar se kërkesa e aplikuesit për kyçje është për katin e dytë (2) dhe se nuk është për katin e parë (1) ku ekziston shifra DPR – 90029614. Madje Bordi i ZRRE ka theksuar se bazuar në korrespondencat mes KEDS/KESCO dhe DMK në ZRRE është vërejtur se fillimisht KEDS ka kërkuar që të dëshmohet legjitimiteti i dy pronareve në këtë pronë apo leja komunale në të cilën dëshmohet ndarja e objektit (kati 1/kati2 ndërmjet pronareve të ndryshëm), por që sipas dëshmive të siguruara nga aplikuesi shihet qartë se objekti posedon dy hyrje të ndara nga njëra tjetra. Bordi i ZRRE ka vërejtur se në korrespondencën mes KEDS/KESCO dhe DMK në ZRRE, DMK në ZRRE ka potencuar qartë se secili nga objektit (njehsori) të jetë i ndarë nga tjetri me instalimet e veta dhe të ketë furnizimet e ndara, dhe jo të jetë një kablo furnizuese për të dy objektet. Bordi i ZRRE gjithashtu thekson se shifra DPR – 90029614 është e regjistruar në emër të B.S. ndërsa kërkesa për lidhje të re është në emër të M.S.

Bordi i ZRRE gjithashtu ka theksuar se në bazuar në të gjitha shkresat e lëndës, si procesverbalin nr.0715056 të datës 6.09.2019, transaksionet e konsumatorit ka vërejtur se shifra e konsumatorit DPR – 90029614 është e regjistruar në emër B.S. dhe se kjo shifër është e regjistruar që nga periudha 08/2003 dhe nga ajo periudhë e tutje kjo shifër ka faturim të rregullt energjisë elektrike, por që kjo shifër ka edhe borxh të energjisë elektrike. Gjithashtu Bordi i ZRRE thekson se organi i shkallës së parë në ZRRE (DMK në ZRRE) me të drejtë ka konstatuar se KESCO ka pasur të drejtë të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore dhe rregullative për inkasimin e borxhit të energjisë elektrike në atë shifër, konform nenit 5 paragrafi 2, nënparagrafi 2.4 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.

Bordi i ZRRE gjithashtu thekson se sipas nenit 51, paragrafi 4 i Ligjit për Energjinë Elektrike, Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund ta refuzojë përkohësisht kyçjen e një konsumatori ose prodhuesi në sistem, nëse konstaton se pajisjet e konsumatorit apo të prodhuesit nuk plotësojnë normat teknike ose kushtet tjera të përshkruara në Kodin e rrjetit të transmetimit dhe Kodin e rrjetit të shpërndarjes. Gjithashtu sipas nenit 10, paragrafi 1 i Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, theksohet se: “Operatori i Sistemit mund të refuzojë të kyçë një aplikues përkohësisht, vetëm nëse ajo kyçje nuk është në përputhje me dispozitat e Kodit të Rrjetit dhe Shpërndarjes ose kodeve tjera në fuqi”. Poashtu sipas nenit 51, paragrafi 4 Ligjit për Energjinë Elektrike dhe nenit 10, paragrafi 2 i Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, operatori i Sistemit është i obliguar t’ia kthejë konsumatorit përgjigjen me shkrim me arsyetimet se ku nuk janë plotësuar kushtet teknike. Për këtë Bordi i ZRRE thekson se bazuar në këto dispozitat ligjore të cekura më lartë, në rastet kur nuk plotësohet kushtet teknike, atëherë aplikuesi duhet të refuzohet përkohësisht me arsyetimet se ku nuk janë plotësuar kushtet teknike në mënyrë që aplikuesi të ketë mundësi t’i eliminojë problemet teknike, pra t’i ofrohet zgjidhja teknike për t’i rregulluar të çështjet teknike.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KEDS se ekipet e KEDS pas vendimit të DMK kanë dalur në teren me datë 30.09.2020 për të inspektuar konsumatorin (aplikuesin) dhe kanë përpiluar procesverbalin nr.0729218 ku kanë konstatuar se konsumatori nuk i ka përmbushur kushtet teknike për kyçje sipas Kodit të shpërndarjes, kapitullit IV, nenit 4, nenit 4.4.1, Bordi i ZRRE thekson qartë se vendimi i organi të shkallës së parë (DMK në ZRRE) është plotësisht i saktë dhe i drejtë pasi që në vendim është kërkuar që bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, KEDS dhe KESCO fillimisht duhet t’i ofrojë konsumatorit zgjidhjen teknike në mënyrë që të plotësohen të gjitha kushtet teknike të parapara në Kodet teknike, dhe më pas pasi të plotësohen kushtet teknike atëherë t’i ofrojë lidhjen e re, respektivisht kyçjen në rrjetin elektrik.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij ka ofruar procesverbalin nr.0729219 të datës 30.09.2020 për të vërtetuar argumentet e KEDS/KESCO, por që



Bordi i ZRRE ka konstatuar se prova e ofruar nuk është provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 14.10.2020 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit M.S. dhe
- Arkivit të ZRRE-së.